

FJALA E DEPUTETIT ARBEN PËLLUMBI

E HËNË 20 DHJETOR 2021

Të nderuar kolegë,

Ky projektligj ka për qëllim një ndryshim në ligjin nr. 55 të vitit 2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që synon zgjatjen e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet e interesuara për procedurat e përfitimit të statusit “investim” apo “investitorë strategjikë”, “procedurë e asistuar apo e veçantë” me dy vjet deri më 31 dhjetor 2023. Ligji nr. 55, i cili, për hir të së vërtetës, nuk është hera e parë që e zgjat afatin, përfundon në dhjetor të këtij viti, pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë prej disa kohësh ka filluar dizenjimin e një projektligji të ri “Për investimet”, si një domosdoshmëri, pasi legjislacioni që kemi sot, krijon një mbrojtje të diferencuar midis investimeve vendase dhe atyre të huaja, në favor të këtyre të fundit. Një korpus të veçantë brenda ligjit të ri “Për investimet” do të zërë edhe projektligji “Për investimet strategjike”. Për mendimin tim, kjo është iniciativë shumë e mirë, pasi synon rritjen e transparencës, si dhe trajtim të barabartë të investitorëve, duke rritur kështu garancinë e tyre. Për fat të keq, projektligji nuk ka arritur të jetë gati ende edhe pse arsyet janë objektive e të forta, pasi për shkak të situatës së tejzgjatur të pandemisë Covid- 19. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është dashur që të gjitha kapacitetet e veta t’i shfrytëzojë në funksion të gjetjes së mundësive sa më të mira dhe efikase për përballimin e pasojave të kësaj pandemie, duke hartuar dhe duke sjellë për miratim në Kuvend një sërë paketash ligjore për rishikimin e buxhetit të shtetit, si dhe politika të tjera fiskale për lehtësimin e biznesit. Një të tillë patëm edhe sot. Për këtë arsye, finalizimi i projektligjit të ri për investimet nuk është bërë ende i mundur.

Sa për informacion, që prej vitit 2015, kur është miratuar ligji nr. 55 e deri më sot, kanë përfituar prej tij 31 projekte investimi strategjik, që ende janë në proces zhvillimi. Madje, do të doja të theksoja që si rezultat i shtyrjes që i është bërë afatit deri më 31 dhjetor të këtij viti, vitin e kaluar kanë përfituar dhe janë miratuar 20 projekte me një vlerë potenciale investimi mbi 3 miliardë euro që kanë sjellë hapjen e rreth 40 mijë vendeve të reja të punës. Disa prej këtyre projekteve shtrihen në zona ku ende nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme dhe për këtë arsye nuk kanë filluar akoma zhvillimin e tyre. Është e qartë se pa përfunduar ky proces, prona nuk vihet në dispozicion të investimit, fillimi do të vonojë, ndonëse ASHK është duke vijuar me procesin, por, sipas informacioneve që kam marrë prej saj, fatkeqësisht do të duhet akoma kohë për përmbylljen e plotë dhe kalimin e pronës në funksion të investimit apo investitorit.

Ndërkohë, afati i statusit strategjik i miratuar rast pas rasti me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike ecën pa u pezulluar, ndaj është normale që për këto projekte me problematikat që përmenda më lart subjektet investuese do të kërkojnë zgjatjen e afatit, si e vetmja mënyrë për të mundësuar zhvillimin e investimit dhe për të përfituar nga masat mbështetëse. Nëse ne nuk e shtyjmë afatin e ligjit nr. 55, do të krijojmë një boshllëk ligjor, në këtë mënyrë do të ndodhë e pashmangshmja, me pasoja si për investitorët, ashtu edhe për shtetin shqiptar. Kjo është edhe arsyeja që unë, i mbështetur edhe nga një numër kolegësh, propozoj që me këtë projektligj ta zgjasim afatin edhe me dy vjet të tjera, deri më 31 dhjetor të vitit 2023, me bindjen se kjo do të jetë një kohë e mjaftueshme edhe për Ministrinë e Financave dhe Ekonominë, por edhe për qeverinë shqiptare për të përmbyllur dhe për të sjellë për miratim në Kuvend projektligjin e ri “Për investimet”. Faleminderit!

